

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT
TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2022**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke e konsideruar Komisionin e Prokurimit Publik si organin më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm për KPP-në paanësinë në vendimmarrje, transparencën, efikasitetin dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen e interesit publik përmes një administrate të përgjegjshme, e cila mirëmenaxhon fondet publike, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve kontraktore;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm rolin që KPP-ja ka në rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë në sistemin e prokurimit publik;

Duke vlerësuar si një arritje tepër të rëndësishme implementimin e reformës së digjitalizimit të shërbimeve dhe menaxhimit të ankesave, me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës dhe minimizimin e korrupsionit;

Shqyrtoi veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2022 dhe vlerëson:

Miratimin e vendimit nr. 329, datë 06.04.2022 të KPP-së “Për miratimin e manualit të autoriteteve kontraktore për përdorimin e sistemeve të ankesave elektronike dhe shqyrtimin e ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike”;

Miratimin e vendimit nr. 328, datë 06.04.2022, “Për miratimin e manualit të operatorëve ekonomikë për përdorimin e sistemit të ankesave elektronike dhe dorëzimin e ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike”;

Miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e KPP-së, me urdhrin nr. 3 të kryetarit të KPP-së, datë 11.01.2022, “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Miratimin e rregullores për funksionimin e bibliotekës së KPP-së me urdhrin nr. 531, datë 03.11.2022 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të bibliotekës së Komisionit të Prokurimit Publik.”;

Shpalljen e procedurave të rekrutimit, me qëllim rritjen e kapacitetit të stafit;

Angazhimin e stafit të KPP-së për të marrë pjesë në trajnime individuale të zhvilluara nga ASPA dhe Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqipërisë gjatë vitit 2022;

Publikimin e procedurave unike në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) gjatë vitit 2022;

Vendimet e marra nga KPP-ja;

Dhënien e informacionit kundrejt kërkesave të ardhura për informim brenda afatit;

Përshpejtimin e kohës për shqyrtimin e ankesave duke ulur treguesin e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit në vlerën 10.1% nga 10.8% në vitin 2021 dhe 22.1% në vitin 2020;

Dërgimin e kërkesave drejtuar autoriteteve kontraktore për zbatim vendimi, pas tejkalimit të afateve ligjore;

Regjistrimin e ankesave dhe marrjen e vendimeve nga KPP-ja gjatë periudhës ku shërbimi i dorëzimit të ankesave nëpërmjet sistemit elektronik nuk funksiononte për shkak të sulmit kibernetik;

Shpenzimet e përgjithshme bazuar në buxhetin e vitit 2022 duke u realizuar në masën 91.73%;

Konstatimin për shkelje nga KPP-ja në procedurat e prokurimit publik nga ana e autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë për çështje, të cilat i janë referuar për hetim administrativ Agjencisë së Prokurimit Publik;

Ngritjen e sistemit të ankesave për KPP-në (e-ankesa), e cila ka vijuar në vitin 2022 me fazën e parë të përditësimit (*up date*) të “Sistemit të dorëzimit dhe shqyrtimit të ankesave, e dizajnuar për të përfshirë/integruar në proces digjitalizimi edhe procese të tjera të brendshme administrative”;

Nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në tetor 2022 mes Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Antikorrupsionit (ANAC), Romë, Itali;

Nënshkrimin e marrëveshjes së themelimit të rrjetit të Organeve Shqyrtuese të Prokurimit të Europës Juglindore mes Shqipërisë, Kosovës, Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut, Rumanisë, Sllovenisë dhe Malit të Zi, në datën 28 tetor 2022 në Tiranë;

Nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes KPP-së dhe KLGJ-së në datën 06.10.2022;

Pjesëmarrjen në aktivitete gjatë vitit 2022;

Realizimin e fushatës sensibilizuese për promovimin e sistemit e-ankesa për një periudhë 1-mujore, tetor-nëntor 2022;

Organizimin në bashkëpunim me SIGMA-OECD të konferencës vjetore të prokurimit publik me autoritetet kontraktore me pjesëmarrje fizike dhe online;

Publikimin e vazhdueshëm të buletineve mujore, si dhe dërgimin e tyre drejt autoriteteve/enteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë në rrugë elektronike.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2023 kërkon që Komisioni i Prokurimit Publik të angazhohet veçanërisht në këto aspekte të veprimtarisë së tij:

1. Të realizohen dhe të merren masa konkrete në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes KPP-së dhe ANAC-së (Autoriteti Kombëtar i Antikorrupsionit), nënshkruar në tetor 2022 në Romë, Itali.

2. KPP-ja të angazhohet lidhur me detyrimet që rrjedhin nga nënshkrimi i marrëveshjes së themelimit të rrjetit të Organeve Shqyrtuese të Prokurimit të Europës Juglindore, përkatësisht për përmirësimin e bashkëpunimit, shkëmbimin e përvojave, mendimeve dhe njohurive për

çështje të veçanta ligjore dhe me rëndësi në punën dhe zbatimin me cilësi dhe efektivitet të kompetencave statutore.

3. Të përmbyllet procedurat e rekrutimit të shpallura. Gjithashtu, të nisë e të përmbyllet edhe procesi për vendet e shtuara nga ndryshimi i strukturës së institucionit në fillim të vitit 2023.

4. Të investohet në rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore duke ndjekur praktikën e suksesshme të bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës dhe institucionet homologe jashtë vendit.

Miratuar në datën 22.6.2023